

VENDIM
Nr.83, datë 17.7.2008

**PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “UNIVERSI”
SHPK**

Në mbështetje të neneve 9 dhe 13 pika 1, germa “d”, dhe 8 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 4, pika 1 germa “d”, dhe 10 të “Rregullores për procedurat e licencimit”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.21, datë 4.4.2007, dhe nenit 18 pika 3 të “Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve, nr.44, datë 24.7.2007, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Sektorit të Energjisë Elektrike (ERE), në mbledhjen e tij të datës 17.7.2008, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Universi” sh.p.k., për t’u licencuar në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike, dhe konstatoi paraqitjen e plotë të dokumentacionit sipas rregullores për procedurat e licencimit,

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për licencimin e shoqërisë “Universi” sh.p.k., në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.
2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut ta njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta